



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministarke Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 12 /2022
Datë: 26 / 01 /2022

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 336 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaremore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-118, në pajtim me nenin 8 (paragrafi 1,nën-paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr.04/2021, Ministrja e Drejtësisë nxjerr:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni për dhënien e provimit për përmbareues privat, në këtë përbërje:

- 1.1 Fejzullah Rexhepi, Kryetar i Komisionit, pyetës për lëndën e Drejta Civile Materiale dhe Procedurale;
 - 1.2 Lumni Sallauka, anëtar i Komisionit, pyetës për lëndën Procedura Përmbaremore;
 - 1.3 Lirije Maksutaj, anëtar i Komisionit, pyetës për lëndën Organizimi i Gjqësorit;
 - 1.4 Dardan Kadolli, anëtar i Komisionit, pyetës për lëndën e Drejta Tregtare;
 - 1.5 Ilirjana Islami, anëtare e Komisionit, pyetëse për lëndën e Drejta Ndërkombëtare dhe të Drejtat e Njeriut;
2. Për sekretari të komisionit caktohet znj. **Fadilete Hoxha**, e cila i kryen punët profesionale dhe administrativo teknike për nevojat e Komisionit.
 3. Obligohet Komisioni për përgatitjen dhe zbatimin e procedurave për dhënien e provimit për përmbareues privat dhe detyrat tjera të përcaktuara me Ligjin për procedurën përmbaremore dhe aktet tjera nënligjore për zbatimin e tij.
 4. Mandati i kryetarit, anëtareve të komisionit dhe sekretarit të komisionit është dy (2) vjet me mundësi vazhdimi.

5. Për punën në komision për provim, kryetari, anëtarët e komisionit dhe sekretari i komisionit kanë të drejtë për kompensim në shumën e caktuar nga Ministri.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Albulena Haxhiu**
Ministre e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Kabinetit të Ministres,*
- *Sekretarit të Përgjithshëm,*
- *Departamenti për Profesione të Lira,*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*